

# Proçes-verbal i mbledhjes 19.12.2025

## Mbledhja e Dhjetorit e Këshillit Bashkiak Kurbin

Data: 19.12.2025 Ora: 09:00

Mbledhja drejtohet nga: Edlira Lleshi, kryetare e Këshillit

### Rend Dite:

1. "Projekt-vendim për miratimin e ndihmës ekonomike 6% muaj Nëntor 2025".
2. "Projekt-vendim për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe numrit të punonjësve"
3. "Projekt-vendim për miratimin në parim të hapave që do të ndiqen për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem 2027-2029"
4. "Projekt-vendim për miratimin e përcaktimit të kriterëve të kualifikimit të vendeve të punës në bashki dhe në institucionet në varësi për vitin 2026"
5. "Projekt-vendim për miratimin e pagës së punonjësve të Bashkisë Kurbin , Njësive Administrative dhe Institucioneve në Varësi për vitin 2026"
6. "Projekt-vendim për miratimin e kalimit me sipërmarrje të shërbimit të pastrimit, grumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane dhe të ngurta , (sheshe , rrugë) të varrezave me afat 3-Vjecar për Njësine Administrative Mamurras , Bashkia Kurbin"
7. "Projekt-vendim për miratimin e kalimit me sipërmarrje të shërbimit të pastrimit, grumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane dhe të ngurta , (sheshe , rrugë) të varrezave me afat 3-Vjecar për Njësine Administrative Milot-Fushe Kuqe, Bashkia Kurbin"
8. "Projekt-vendim për miratimin e kërkesës së Bashkisë Kurbin( fondi I emergjencave dhe ai I kushtëzuar), për familjet e dëmtuara, banesat e të cilëve preken nga përmbytjet si pasojë e shirave në datat 18 deri 26 nëntor 2025 në territorin e Bashkisë Kurbin.
9. Projekt-vendim për miratimin e linjave të transportit dhe të çmimit, për mësuesit që punojnë dhe nxënësit që mësojnë jashtë vendbanimit të tyre"
10. "Projekt-vendim për miratimin e një shpërblimi për nxënësit ekselent të vitit mësimor 2024-2025"
11. "Projekt-vendim për miratimin e një ndihme financiare për disa familje"
12. "Projekt-vendim për miratimin e bursave të nxënësve të arsimit profesional për vitin mësimor 2025-2026"
13. Projekt -vendim për miratimin e bursave të nxënësve të arsimit parauniversitar për vitin mësimor 2025-2026".
14. "Informacion lidhur me efektet ekonomike dhe financiare për nxjerrje jashtë përdorimit të inventareve të aktiveve të qëndrueshme dhe të imta për vitin 2025, në Këshillin Bashkiak dhe të gjithë institucionet në varësi"
15. "Informacion mbi Sistemin e Matjes së Përformancës së Bashkisë Kurbin-Raporti 2024".
16. **Të ndryshme**

Të ndryshme .

**Mbledhjet e komisioneve u zhvilluan:**

1. Komisioni ekonomik i veprimtarisë financiare dhe buxhetit mbledhja date 6.12.2025 ora 11;00
2. Komisioni i Arsimit,Kultures dhe Sporteve mbledhja date 16.12. 2025 ora 12.00
3. Komisioni i rendit dhe i mbrojtjes civile mbledhja date 16.12. 2025 ora 13.00

**Të pranishëm: 29 këshilltarë në fillimin e mbledhjes, sipas listëprzencës.**

**Pjesëmarrës nga administrata:**

- **Majlinda Cara Kryetare e Bashkisë .**
- **Eduart Kurti, nënkryetar i Bashkisë**
- **Iris Tahiraj drejtoresha DPKZHT**
- **Jeton Cakoni drejtori zyres Juridike**
- **Dolfi Toma drejtori i sherbimeve publike**
- **Kristina Gjoka ing DPKZHT**
- **Bardha Pojani drejtoresh e Arsimit,Kultures dhe sporteve .**
- **Ilir Paja pergjegjes i Pallatit të Kultures.**
- **Jetmir Mzhika drejtori I IMT**
- **Amarildo Buqpapa drejtori i taksave.**
- **Drita Kodra specialiste e taksave.**
- **Rake Kola, Drejtorja e Financave**
- **Artan Miza Drejtori i Pyjeve dhe kullotave.**
- **Klodiana NOKA Juriste Bashkisë.**
- **Llesh Ndoci, Drejtorja e Ndhmës Ekonomike**

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit:** Fillojmë mbledhjen duke venë re numrin e Këshilltareve . Me rendin e ditës, besoj se jeni njohur? A jeni dakord me rendin e ditës?

**Miratohet rendi i ditës dhe procesverballi i mbledhjes të kaluar të gjithë dakort 29 vota. Kundra s'ka abstenim s'ka**

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit;** Fillojmë. Sipas pikës së parë, projektvendim për miratimin e ndihmës ekonomike 6% muaj nëntor 2025. Tashti, a ka nevojë për diskutim? Ta hedhim në votim. Kush është dakord? Kundër? **Miratohet.ndihma ekonomike 6% ,29 vota pro kunder ska abstenim ska.**

Projektvendim për miratimin e buxhetit të vitit 2026, numrit të punonjësve. Atëherë këshilli i ekonomisë është mbledhur. Kryetari i komisionit do t'ju thotë dy fjalë edhe pastaj diskutimet. Mendoj se ishin të ndihmës ekonomike këto që dolën – okej, o Pashk, Pashk Prenga,

**Pashk Prenga;**Atëherë, mirëmëngjes, përshëndetje të gjithëve. Para dy ditëve është mbledhur komisioni i ekonomisë në lidhje me buxhetin, projektbuxhetin e vitit 2026. Realisht të gjithë anëtarët kanë pasur pyetje, edhe lidhur me administratën e bashkisë dhe me materialin që është paraqitur. Tash për në detaje, këtu ka arsye me përsërit 20 herë shifra. Besoj se për këtë do sqarojë edhe stafi i bashkisë. Ne si komision e kemi miratuar projektbuxhetin në vitin 2016. Për shifra më të hollësishme pastaj janë specialistet që flasin.

Unë ju ftoj ta votoni.

**Etmond Stojani;** Atëherë, po po, i drejtohem edhe drejtor Pashkut si ish këshilltar i vjetër. Nuk e di a keni parë mirë gjithsesi. Kur të vazhdojmë të diskutojmë, do t'i shohim më mirë ato gjërat, kryetare. Për momentin e marr fjalën pak më vonë.

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit;**Nuk, nuk të kuptova. Do flasësh më vonë? Po, po. Kush e do fjalën? Me doni? Doni prapë një përmbledhje nga Rakja? Berca, o të lutem shumë, është shumë herët. Po është shumë herët me ja fut. Do flasim vetëm brenda rendit të ditës. Rake, të lutem.

**Rake Kola shefe e finances;** Kurbin për vitin 2026. Bashkia Kurbin, referuar bazueshmërisë ligjore, ligji 139 të qeverisjes vendore, ligjit 9936 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligji 10.296 për menaxhimin dhe kontrollin financiar, udhëzimi numër 23 të 2018 për procedurat standarte të hartimit të buxhetit afatmesëm për njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe në shkresën numër 15.867/6/11/2025, ku dërgohet për njoftim transferata e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale për vitin 2026 për Bashkinë Kurbin, si dhe referuar paketës fiskale të miratuar me vendim të këshillit bashkiak për miratimin e të ardhurave për vitin 2026 dhe buxhetin afatmesëm 26-28, ka hartuar buxhetin afatmesëm 2026-2028 dhe përfshirë dhe buxhetin e vitit 2026. Bashkia Kurbin funksionon me 12 programe buxhetore që janë: planifikimi, menaxhimi, administrimi, programi i mbrojtjes nga zjarri dhe kullimit, menaxhimi i pyjeve dhe kullotave, menaxhimi i rrugëve rurale, shërbimet sociale, çerdhe, qendra e të moshuarve, zhvillimi i komunitetit, shërbimet publike vendore, menaxhimi i mbetjeve, shërbimet kulturore, Pallati i Kulturës, zhvillimi dhe mbështetja e arsimit, rinisë, kulturës dhe sporteve, arsimit parashkollor dhe ai bazë, dhe arsimit mbështetës i përgjithshëm. Sipas një përshkrimi të shkurtër kemi bërë detajimin e të gjithë këtyre programeve buxhetore se si funksionojnë. Bashkia Kurbin harton, miraton, zbaton, administron çdo vit buxhetin afatmesëm dhe buxhetin vjetor. Referuar ligjshmërisë në fuqi, është përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Bashkia, qeverisja vendore, ofron shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që jep ligji dhe përfshin llogaritjen e shpenzimeve siç janë pagat, sigurimet, mallrat, shërbimet, investimet, si dhe vendime strategjike që bëhen në efekt të investimeve publike. Procesi i PBA-së prezantohet në mënyrë të integruar, një informacion të përgjithshëm për të gjitha këto burime dhe llojet e shpenzimeve që parashikohen në buxhetin e Bashkisë Kurbin. Në të njëjtën kohë ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve, duke treguar se si shpenzimet publike me prioritet

strategjik janë ato të para që ofrohen këtyre banorëve. Gjithashtu, PBA-ja na siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke prioritaruar ato që janë më të rëndësishme sipas analizave të thella. Çështjet kryesore të projekteve dhe politikave, Bashkia Kurbin ka përcaktuar disa drejtime kryesore të zhvillimit siç është zhvillimi ekonomik i mbështetur në industrinë e lehtë, kryesisht dhe në bujqësi, promovimi i bashkisë për agroturizëm dhe kulinari, mbrojtja e shtresave në nevojë me kujdes social, mbështetja e biznesit për të kapërcyer vështirësitë në jetën e tyre. Sipas udhëzimeve në fuqi, Bashkia Kurbin ka kaluar në miratimet e tavaneve përfundimtare të buxhetit afatmesëm 26-28, bazuar në ligje, ku përfshihen pesë vite nga të cilat është faktikisht 2024, i pritshmi i 2025 dhe parashikimi për 26, 27 dhe 28-ën. Buxheti i vitit 2026 është pjesë e këtij programi afatmesëm 2026-28 dhe ka si objektiv krijimin e premisave për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social, kulturor dhe territorial të bashkisë, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve cilësore dhe shtrirjen e tyre në të gjithë hapësirën territoriale të Bashkisë Kurbin. Në tërësinë e vet, buxheti i 2026, buxheti afatmesëm janë dokumente që përmbledhin tërësinë e të ardhurave dhe financimeve, shpenzimeve të miratuara me ndihmën e këshillit bashkiak. Janë një instrument i rëndësishëm për menaxhimin e financave të qeverisjes vendore. Janë mjet komunikimi ndërmjet qytetarëve dhe të zgjedhurve vendorë. Janë dokumenti që lidh prioritetet e bashkisë nën kushtin e burimeve financiare të kufizuara dhe janë produkt i një bashkëpunimi në struktura të brendshme që lidhen me përgjegjësi ligjore me të bashkisë dhe njësitë administrative, institucionet e varësisë. Ai shpreh në mënyrë të sigurt burimin e të ardhurave, përdorimin e tyre dhe mat indikatorët. Pra, i vjen nga një proces i gjatë analizash dhe konsultimesh. Objektivat e buxhetit të Bashkisë 2026 janë: vazhdimi i përmirësimit të ndjeshëm të infrastrukturës rrugore në qytet dhe atyre rurale; ofrimi i shërbimeve në çdo njësi administrative me qëllim përmirësimin e standardit të jetesës së popullsisë rurale; përfundimi i investimeve të filluara gjatë vitit 2025, të cilat janë parashikuar afat trevjeçar; vazhdimi i likuidimit të detyrimeve të prapambetura që bashkia Kurbin ka trashëguar nga reformat territoriale dhe në vijim; dhe rritja e numrit të aktiviteteve kulturore dhe sportive që do të zhvillojë Bashkia Kurbin. Tregues të rëndësishëm të buxhetit. Bashkia Kurbin ka burimet e buxhetit nga tre burime kryesore: nga burimet e veta, nga burimet e qeverisjes vendore, si dhe nga burimet e të ardhurave të trashëguara që trashëgohen nga viti 2025 deri në 2026. Në burimet e veta përfshihen taksa, tarifa, shërbime publike, të ardhura nga shitjet, dhënia me qira e të tjera, të cilat përfshijnë edhe detyrimet e papmbledhura ndër vite, e cila është parashikuar në paketën fiskale të miratuar me ndihmën e këshillit bashkiak. Në burimet qëndrore përfshihen transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme dhe transfertat specifike sektoriale, për të gjitha ato agjenci që janë atashuar pranë Bashkisë Kurbin. Funkcionet që financohen nga transfertat specifike sektoriale janë personeli, personeli mësimor dhe jo mësimor i arsimit parashkollor dhe personeli arsimit i arsimit parauniversitar, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri, rrugët rurale, infrastruktura rrugore, administrimi i pyjeve, ujtitja dhe kullimi. Një burim tjetër i të ardhurave janë... Ishte kërkesa e këshilltarëve të lexoj një çik edhe burimet edhe kë...

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit:** Me leje, po po, Edmond Stojani.

**Edmond Stojani;**Atëherë, një pyetje drejtorit të financës edhe kryetares së bashkisë njëkohësisht. Përpara se të na kërkon miratimin e buxhetit 2026 për programin buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028, duhet të raportoni për investimet e bëra deri më sot. Në

projektvendimin për miratimin e buxhetit 2024 kemi miratuar 23 projekte të reja investimesh sipas PBA-së 2024-2026. Pyetja ime është: sa nga këto janë përfunduar dhe sa janë në proces? Mund t'i lexoj edhe nëse doni ato që kemi pasur planifikuar. Tani fillojmë nga rikualifikimi i shesheve Laç. Pyetje: janë bërë punime? Asfaltimi i rrugës Shkorreti–Lekaj? Janë bërë punime. Asfaltimi i rrugës Likaj–Demokracia? Janë bërë punime. Dhe po të vazhdojmë me lexu 23 me radhë, besoj se mund të humbim kohë. Sa nga këto janë përfunduar dhe sa janë në proces?

Kjo ishte pyetja e parë, i marrim me radhë pyetjet.

**Rake Kola;**Okej, atëherë, nga një analizë që është bërë investimeve të 2025-s, unë relatoj që punimet që janë kryer përfundimisht dhe janë marrë në dorëzim janë: asfaltimi i rrugës Stacioni i Trenit Porrimore e Mamurras, asfaltimi i rrugës Zhej–Varreza, asfaltimi i rrugës Sanxhak nga shkolla, rruga Artan Farka, asfaltimi i rrugës Sanxhak, rruga e Kampit. Janë bërë blerje kompjutera, printera, blerje kontejnerësh. Janë bërë furnizim dhe vendosje për Pallatin e Kulturës, blerja e mobiljeve për kopshtin numër tre, si dhe hartimi i projekteve si për pallatin numër 84 dhe për projektet e rrugëve. Për të gjitha rrugët që janë në proces tenderimi, janë lidhur kontratat dhe janë në proces punimesh: rehabilitimi i rrugës, asfaltimi i rrugës së tankeve, asfaltimi i rrugës "Poligoni", bashkimi me unazën dhe asfaltimi i rrugës në Nerlallaj. Janë të kontraktuara dhe janë në proces punimi. Në bazë të projekteve, sepse thashë janë hartuar projektet për 19 rrugët që ishin projekte të reja. Në bazë të projekteve që janë shpallur, janë bërë grupimet e këtyre rrugëve dhe janë në proces prokurimesh: 19 rrugë sipas njësive administrative janë në proces prokurimi, 19 rrugë të tjera të reja që janë të palidhura kontratat akoma.

**Etmond Stojani;**Këto 19 rrugët janë të buxhetit të 2024.

**Rake Kola;**Janë të buxhetit afatmesëm 2025, 2026, Dhe unë, sa herë që relatoj, them: është buxhet afatmesëm dhe buxheti i vitit është i pari, dhe janë dhe dy vite financim; dhe këto, përderisa ishin në proces për t'u hartuar projektet, janë marrë projektet në dorëzim nga zyra e urbanistikës dhe është hedhur procedura e prokurimeve dhe janë në proces prokurimesh.

**Etmond Stojani;**Pyetje tjetër: në vend që me i bë 19 për njëherë, a nuk ishte e mundshme me i bë tre, katër?

**Rake Kola;**Hartimi i projekteve do bëhet në grup. Se kishim, ne, nëse lexon listën e investimeve, kur kemi investuar.

**Etmond Stojani;**Tre katër të parat, përse nuk keni bërë me këtë 19?

**Rake Kola;**Këto kanë qenë buxheti i 2024, 25, 26-ës, nuk kanë qenë buxhet i 25-ës si vit fillestar investimit. Pra, tre vitet e financimit janë: viti i parë fillestar që fillon procedura, dhe pastaj janë tre vite financim, sepse kështu është.

**Etmond Stojani;** Unë të bëra pyetjen: nga këto 23 investime, jam dakord me blerjen e kontejnerëve – i lexova – dhe

**Rake Kola;** Rrugët, i nderuar këshilltarë. Unë lexova dhe rrugët: është Stacioni i Trenit Përrimore, është rrugë, është rruga e Zhejës–Varreza, është rrugë, Sanxhak rruga, Artan Farka,

është rrugë, rruga e Kampit, është rrugë, përveç këtyre të tjerave, dhe është dhe hartim projektsh dhe pa u bërë projektet. Normalisht që janë procedura të cilat...

**Etmond Stojani;** Të pyeta për 23 investime, katër prej tyre janë bërë, bie sikur 19 të tjerat.

**Rake Kola;** Të tjerat janë në proces tenderimi dhe në momentin që të lidhen kontratat, janë me tre vite financim, i nderuar këshilltar, dhe brenda tre viteve, më thotë, do të kryhen të gjitha.

**Laurin Sana;** Pra, praktikisht duhen nja 10 vjet që të bëhen 19 rrugë për me u ushtru dhe kanë dy mandate.

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit:** Laurin, të lutem, ajo është 19 e 4 të tre bien, kështu që...

**Etmond Stojani ;**Te projektbuxheti afatmesëm 2025-2027, sa nga 21 projektet e reja të investimeve janë përfunduar dhe sa janë papërfunduar? Sepse kemi 21 të reja, 2025-2027.

**Rake Kola;**Unë t'i relatova të gjitha, atëherë këto kam.

**Etmond Stojani ;**Ti i relatove të gjitha, po ta bëjmë llogari: 21 + 23 i bie diku te 50, heqim perdet 21 + 23. Po pra, ku i mblodhi 21 + 23? Atëherë, t'i lexojmë me copë se kohën e kemi.

**Majlinda Cara Kryetare e Bashkisë;**Të lutemi, të nderuar këshilltarë, janë 22 projekte, 19 janë vetëm infrastrukturë. Të 19 projektet e infrastrukturës rrugore janë mbyllur nga Bashkia Kurbin dhe janë grupuar 19 në tre lote. Janë të gjitha në fazë prokurimi për t'u futur në kantier. Në momentin që lidhet kontrata, afatet dhe procedurat janë të përcaktuara në ligj, dhe do jemi në ata të tjerë. Këta janë të miratuar në PBA me financim 2026, 2025-2026 edhe 2027. Për të gjithë investimet e miratuara në buxhetin e kaluar, ne jemi në fazë prokurimi sepse duhet të hartonim projektet e rrugëve që të futeshim në investim, dhe janë hartuar, janë marrë në dorëzim 19 projekte.

**Etmond Stojani;** Amund t'i dimë me emra cilat janë? Të

**Majlinda Cara Kryetare e Bashkisë;**19, të gjitha emrat që ke në projektin e 2020, po me emrat, t'i lexojmë edhe ta dimë janë: të kisha, asfaltimi i rrugës 246-ës apo 2025-27 pra, 25-26 asfaltimi i rrugës Kisha, është Nanoit Lapidari i Selitë, asfaltimi i rrugës Liqeni–Sanxhak Kurbin, asfaltimi i rrugës Katuni i Ri, asfaltimi i rrugës Rrënoja–Mal Bardhë-Fushë, asfaltimi i rrugës Patokut, Patokut-Shyti Fushmilot–Kurbin (sepse kështu kanë adresat në ASIG), ndërtimi i terreneve sportive shkolla Migjeni Mamurras (këtu jemi në proces lidhje kontrate që të jemi domethënë, e shpall fituesi, lidhet kontrata), është asfaltimi i rrugës Alku–Fushkuqe, asfaltimi i rrugës Karburanti–Kukulagj, asfaltimi i rrugës e Bushëve–Unaza Laç, asfaltimi i rrugës Reçi–Gjorëm Mamurras, asfaltimi i rrugës Kasemaj–Gjorëm–Kodër–Mamurras, asfaltimi i rrugës Rezervuari–Zhej, asfaltimi i rrugës Tukëve–Fushgjormë, asfaltimi i Unazës Mamurras, asfaltimi i rrugës së Xhamisë Mamurras, asfaltimi i rrugës Shullaz–Kodër, asfaltimi i rrugës Dituria Paraqita Mamurras, asfaltimi i rrugës Likaj–Sanxhak Poshtë dhe asfaltimi i rrugës Sadik Liga–Sanxhak Poshtë. Të gjitha këto janë marrë në dorëzim projektet, janë grumbulluar në tre lote, jemi në fazë prokurimi për t'u futur në investim.

**Etmond Stojani;** Atëherë, cilat janë që kemi në 2024, cilat janë në 2025-ën?

**Majlinda Cara Kryetare e Bashkisë;** 2025 pra janë këto. 2024, 2025, 2026. Ke pas rrugën Kodër Laç, rrugën Nerlaj Milot, edhe rrugën e tankeve, që të treja dy janë futur në kantier, rruga e tankeve për punë ditësh, është vetëm procedura e dhënies së lejes së ndërtimit, lejes së punimeve. Tani këto janë 19 projekte të infrastrukturës, si dhe rehabilitimi i lagjeve. Këtu, jemi në fazë prokurimi, por për shkak të një ndryshimi që bëjmë në projekt, për arsyen se po mbyllim punimet e përroit në mes të qytetit dhe, duke qenë se duhet ta kalojmë sistemimin e përroit në një lloj infrastrukture pedonale për gjithë qytetin, kemi shkuar në një ndryshim projekti për ta kaluar edhe pjesën ku ka përroi i qytetit, që është drejt përfundimit të punimeve dhe është në fazë prokurimi edhe ky. Kështu që të gjithë investimet 2025 deri në 31 dhjetor të 2025 janë të gjitha për ezaurim Ndërkohë, sot vjen për miratimin e buxhetit 2026 për bazë deri në 2028-ën. Kërkojmë miratimin tuaj. Diskutime të

**Edmond Stojani;tjera tashti?** A kemi ardhur me fol apo...?

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit;** Po dakord, pra me fol, po nuk do ta bëjmë bashkëbisedim midis teje e asaj, janë dhe 30 të tjerë këtu.

**Edmond Stojani;**Unë e kam pyetje–përgjigje, pyetje–përgjigje. Nuk mund t’i rreshtoj të gjitha, sepse atëherë bëhet mishmash. Po, atëherë pyetja tjetër: te numri i punonjësve, te buxheti i 2025 ka qenë 607 plus shtatë instruktorë të jashtëm të përkohshëm, dhe i bie 607 + 7,

**Majlinda Cara Kryetare e Bashkisë;** Ndryshimin. 18, prit që relatojmë për ndryshimin tani. Mbledhje-zbritje këtu. Nëse ti ke.

**Edmond Stojani;**Ndryshimin, ta mbaroj pyetjen? Po, ndërsa te buxheti i 2016 kërkoni 616 plus dy me kontratë të përkohshme, pra këtu janë dy që nuk i kemi miratuar ne, dhe i kemi futur 616 punonjës, ne kemi miratuar 607 + 7, 614.

**Majlinda Cara Kryetare e Bashkisë;**Kë nuk ke miratuar? Ti nuk e marr vesh kë nuk ke miratuar. Ti, me kontratë të jashtme, i kemi miratuar në mbledhjet e radhës më përpara, që janë financim i kompanisë Titan për Anteja Titan për dy roje në shkollën Fushmamurras, dhe ke miratuar me kontratë të jashtme tjetër. Me kontratë të jashtme s’kemi. Nëse do ndryshimet, unë t’i jap pa bërë pyetjen fare.

**Edmond Stojani;**Janë, do t’i qartësoj gjërat duke i nisur me fotot e grupit të ËhatsApp-it. Dua me sqaruar kolegët.

**Majlinda Cara Kryetare e Bashkisë;**Me kujt në grup të ËhatsApp-it, të lutem, ku kanë materialin, keshilltarët... O zoti Edmond, kalo kanë materialin.

**Edmond Stojani;**Kalojmë te thembra e Akilit dhe shumë pyetje direkte: çfarë janë shumë sportet? Çfarë janë shumë sportet? Keni, na keni specifikuar një zë aty: "shumë sporte".

**Edmond Stojani:** Pyetje: çfarë janë, drejtorinë e shumë sporteve?

**Majlinda Cara Kryetare e Bashkisë ;**Të gjithë në Drejtorinë e Arsimit, Kulturës dhe Rinisë, që merret me aktivitete sportive, ku mund të përfshihet edhe gjithë aktivitetet sportive që bëhen nëpër shkolla, por edhe klubi i futbollit, ku ke inspektor shumë sportesh që ndjekin gjithë ato.

**Etmond Stojani;** Do të ishte më mirë t'u përgjigjte drejtoresha, jo specialistja, nuk është Për o kryetare, këtu nuk jemi në lakros, nuk je ti, është drejtoresha.

**Majlinda Cara Kryetare e Bashkisë;**Personeli i burimeve, drejtoresha njerëz–struktura; është kompetencë e kryetarit të bashkisë. Burimet njerëzore nuk janë të drejtorit.

**Etmond Stojani;**Në qoftë se ke hartuar ti, ok, përgjigju ti; në qoftë se ka hartuar ai, drejtoresha të kemi.

**Majlinda Cara Kryetare e Bashkisë** O zotëri, po i ngatërron kompetencat; kryetari bashkisë i propozon.

**Etmond Stojani;**Thashë, unë nuk e di kush e propozoi. I bëra pyetje drejtoresha së financave: çfarë janë shumë sportet?

**Majlinda Cara Kryetare e Bashkisë;**S'ka drejtoresha e financave kompetencë për strukturën, o zotëri, është Drejtoria e Burimeve Njerëzore.Një sektor pranë Drejtorisë së Arsimit, Kulturës dhe Rinisë pranë bashkisë që merret me aktivitete sportive. Janë disa inspektorë të shumë sporteve që ndjekin gjithë aktivitetet sportive nëpër gjithë territorin e bashkisë, po edhe në shkolla, realizimin e aktiviteteve, por edhe të klubit të futbollit.

**Etmond Stojani;**Tani, te këto "shumë sportet", në 2024-ën na keni thënë: qira fushë, federime, aktivitete,

**Majlinda Cara Kryetare e Bashkisë;**Terrene sportive, ato – mos ngatërro shumë sportet me terrenet sportive. Qira fushë për gjithë të rinjtë, akademinë e klubit të futbollit.

**Etmond Stojani;**Të me sqaruar kolegët, në qoftë se nuk e keni bezdi, kam nisur diçka në grupin e ËhatsApp-it. Pra, në 2024-ën shumë sporte...

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit;**Të lutem. Ideja është, këtu jemi për procedurë. Nuk ka lidhje ËhatsApp. Tashi, unë po të jap mundësinë Edmond për respekt. Edhe një problem të fundit, meqë.

**Shenim; Atëherë kemi edhe problemin që na iken dritat në sallë dhe mbledhja do të zhvillohet pa live. A jeni dakort?**

**Anton Kolziu;**Unë mendoj që të presim dritat pra s'jam dakort .

**Sefedim Lika;** Edhe unë mendoj që te presim dritat eshte projekti me I rendesishem I vitit. S'na e keni bere ndonjehere kete gje me na fik dritat mos me na lan me u shpreh.

**Majlinda Cara Kryetare e Bashkisë;**Eshtë problem për gjithë qytetin ja na e konfirmon edhe drejtori i Oshes ne telefon live.

**Albana Gjeta;**Unë propozojn në emer të Këshilltarëve të magjorancës ta zhvillojm mbledhjen.

**Aida Skeja;**Unë mendoj që mbledhja të vazhdoje se ne kemi zhvilluar shumë vite mbledhje pa kamëra.

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit;** Hedhim në votim propozimin e zonjës Albana Gjeta për të zhvilluar mbledhjen.

**Miratohet propozimi për të zhvilluar mbledhjen 19 vota pro 10 vota kunder abstërnim ska**

Atëherë për buxhetin ka pyetje tjetër apo votojm. po votojm 1)“Projekt-vendim për miratimin e buxhetit te vitit 2026 dhe numrit të punonjësve”

2)“Projekt-vendim për miratimin në parim të hapave që do të ndiqen për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem 2027-2029.

Kush është pro dhe kush kunder dhe kush abstërnim për të dy projektet e mesiperme?

**Miratohet 1) “Projekt-vendim për miratimin e buxhetit te vitit 2026 dhe numrit të punonjësve” 2) “Projekt-vendim për miratimin në parim të hapave që do të ndiqen për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem 2027-2029 me 17 vota pro, 9 vota kundër dhe 3 Këshilltarë nuk votojn.**

**Shenim pas miratimit të buxhetit Këshilltarët 1. Laurin Sana ,2. Sefedin Likaj ,3. Anton Kolziu,4. Aleksander Jakaj, 5. Eris Zymaj,6. Albert Ndoci 7. Etmond Stojani lënë sallën e Këshillit. Mbeten në sallë 22 këshilltarë**

**Alba Gjeta; Kryetare e grupit të Këshilltareve të magjorancës** Kryetare propozoj ti hedhim në votim s’kemi diskutime i kemi lexuar materialet.

**Miratohet propozimi 22 vota pro kunder 0 abstërnim 0**

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit; Miratohet 22 vota pro kunder 0 abstërnim 0** “Projekt-vendim për miratimin e përcaktimit të kriterëve të kualifikimit të vendeve të punës në bashki dhe në institucionet në varësi për vitin 2026”

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit; Miratohet 22 vota pro kunder 0 abstërnim 0** “Projekt-vendim për miratimin e pagës së punonjësve të Bashkisë Kurbin , Njësive Administrative dhe Institucioneve ne Varësi për vitin 2026”

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit; Miratohet 22 vota pro kunder 0 abstërnim 0** “Projekt-vendim për miratimin e kalimit me sipërmarrje të shërbimit të pastrimit, grumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane dhe të ngurta , (sheshe , rrugë) të varrezave me afat 3-Vjekar për Njësine Administrative Mamurras , Bashkia Kurbin”

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit; Miratohet 22 vota pro kunder 0 abstërnim 0** “Projekt-vendim për miratimin e kalimit me sipërmarrje të shërbimit të pastrimit, grumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane dhe të ngurta , (sheshe , rrugë) të varrezave me afat 3-Vjekar për Njësine Administrative Milot-Fushe Kuqe, Bashkia Kurbin”

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit; Miratohet 22 vota pro kunder 0 abstërnim 0** Projekt-vendim për miratimin e kërkesës së Bashkisë Kurbin( fondi I emergjencave dhe ai I kushtëzuar), për

familjet e dëmtuara, banesat e të cilëve preken nga përmbytjet si pasojë e shirave në datat 18 deri 26 nëntor 2025 në territorin e Bashkisë Kurbin.

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit; Miratohet 22 vota pro kunder 0 absternim 0** Projekt-vendim për miratimin e linjave të transportit dhe të çmimit, për mësuesit që punojnë dhe nxënësit që mësojnë jashtë vendbanimit të tyre”

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit; Miratohet 22 vota pro kunder 0 absternim 0** “Projekt-vendim për miratimin e një shpërblimi për nxënësit ekselent të vitit mësimor 2024-2025”

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit; Miratohet 22 vota pro kunder 0 absternim 0** “Projekt-vendim për miratimin e një ndihme financiare për disa familje”

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit; Miratohet 22 vota pro kunder 0 absternim 0** “ Projekt-vendim për miratimin e bursave të nxënësve të arsimit profesional për vitin mësimor 2025-2026”

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit; Miratohet 22 vota pro kunder 0 absternim 0** Projekt -vendim për miratimin e bursave të nxënësve të arsimit parauniversitar për vitin mësimor 2025-2026”.

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit; Mbyll mbledhjen e Këshillit Laç më 19.12.2025.**

**Sekretari i Këshillit**

Arber LEKA